

**AKT THEMELIMI**  
**i shoqërisë "SFINKSI" Sh.p.k**

Sot, më datë 18/07/2024,

- Z. Viktor Laka, shtetas shqiptar, i lindur në Buz, më 03.11.1982, identifikuar me numër personal I21103140S, madhor e me zotesi te plote juridike e per te vepruar

- Z. Ekland Dauti, shtetas shqiptar, i lindur në Gurakuq, më 10.10.1971, identifikuar me numër personal H11010151E, madhor e me zotesi te plote juridike e per te vepruar

Në përputhje me ligjin 9901, datë 14.04.2008, "Për tregëtarët dhe Shoqëritë Tregëtare" (i ndryshuar) dhe ligjit nr. 9723, dt. 03.05.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", kane vendosur të themelojne një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar të emërtuar "SFINKSI" sh.p.k. (më poshtë referuar si "**Shoqëria**")

**Neni 1**  
**Emërtimi**

Emri i shoqërisë është "**SFINKSI**" Sh.p.k.

**Neni 2**  
**Selia**

Selia zyrtare e Shoqërisë ndodhet në adresën: "Lagja Skenderbej, Zona industriale jug, Godina 56, Zona kadastrale 8523, nr. pasurie 33/107, Elbasan."

Asambleja e ortakëve mund të themelojë filiale, seli dytësore ose njësi të tjera operative si dhe të transferojë selinë e shoqërisë në një adresë apo qytet tjetër.

**Neni 3**  
**Kohëzgjatja**

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë për një afat të pacaktuar, përvec zgjatjes ose prishjes së mëparshme të saj sipas Vendimit të Asamblesë së Ortakëve.

**Neni 4**  
**Objekti**

-Shoqëria ka për objekt të saj "Sherbim privat i Sigurise Fizike-SH.P.S.F"

-Sigurim fizik i objekteve shtetërore dhe private, i personave, si dhe i veprimtarive social-kulturore, sportive, fetare e politike;



**Neni 5**  
**Kapitali Themeltar**

Kapitali themeltar është i përbërë nga kontributet në të holla të ortakëve themelues në vlerën 2,000,000 (dy milion) Lekë. Kapitali themeltar përbëhet nga 2 (dy) kuota me vlera nominale jetë 1,400,000 lekë dhe pjesa tjetër 600,000 lekë, e cila paguhet me celjen e shoqërisë .

**Neni 6**  
**Organet e Shoqërisë**

Organet e shoqërisë përbëhen nga Asambleja e ortakëve dhe Organi Administrativ;

1. Asambleja e Ortakëve është organi vendimmarrës e shoqërisë e cila vepron në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.
2. Organi i vetëm administrativ i shoqërisë është Administratori i vetëm, z. Viktor Laka shtetas shqiptar, i lindur në Buz, më 03.11.1982, identifikuar me numër personal I21103140S, i cili zgjidhet për një afat 5 (pese) vjecar, me të drejtë rizgjedhje.

**Neni 7**  
**Legjislacioni i aplikueshëm**


Aktiviteti i shoqërisë do të rregullohet nga dispozitat e statutit të shoqërisë, si edhe nga të gjitha dispozitat ligjore në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

**Neni 8**  
**Dispozita Finale**

Ky akt themelimi hartohet në 3 (tre) kopje origjinale në gjuhën shqipe. Përmbyajtja e Aktit të Themelimit u lexua dhe nënshkrua nga Ortaket themelues te shoqërisë duke autorizuar Administratorin znj. Viktor Laka, për të kryer të gjitha veprimet e nevojshme për regjistrimin e shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) në Tiranë.

**ORTAKËT**

1. Viktor Laka

Viktor Laka 

2. Ekland Dauti

EKLAND DAUTI 